



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DATE/A	28.03.2023
Për:	Arben Krasniqi, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit
Përmes	Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Nga	Fehmi Zena, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Lënda:	RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE, JANAR- DHJETOR 2022

I nderuar z. Krasniqi,

Ministria e Pushtetit Lokal, në përputhje me përgjegjësit ligjore të përcaktuara më Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht nenin 86, mbikëqyrë veprimtarinë e komunave të Republikës së Kosovës dhe ka hartuar Raportin Janar- Dhjetor 2022, lidhur më funksionimin e kuvendeve të komunave për këtë periudhë me të cilën MAPL, është përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin periodik dhe vjetor lidhur më funksionimin e kuvendeve të komunave në Qeveri.

Bashkëngjitur gjeni Raportin e funksionimit të kuvendeve të komunave, Janar- Dhjetor 2022 për publikim.

Me respekt!

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Ky raport pasqyron funksionimin e kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës. Këtu janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur aktivitetet e komunave dhe trupave ndihmëse të tyre, për periudhën Janar - Dhjetor, 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

**RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË
KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**
JANAR-DHJETOR 2022

Prishtinë, Shkurt 2023

PËRMBAJTJA:

Qëllimi i raportit	4
Përmbledhje ekzekutive	5
1. Funksionimi i kuvendeve të komunave	6
2. Komitetet e përhershme të kuvendeve të komunave.....	9
3. Komitetet e tjera të kuvendit të komunës	11
4. Komitetet konsultative të kuvendit të komunës	12
5. Takimet publike me qytetarët	13
6. Raportimi i kryetarit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës.....	14
7. Aktet e kuvendeve të komunave	14
7.1 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve	15
7.2 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministria e Pushtetit Lokal	16
7.3 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministrit e linjës	17
8. Këshilli Komunal për Siguri Në Bashkësi.....	18
8.1 Temat e trajtuara lidhur me sigurinë në bashkësi.....	19
8.2 Sfidat lidhur me sigurinë ne bashkësi	19
Rekomandimet.....	20

QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe grupeve tjera të interesit, për funksionimin e komunave konform mandatit të përcaktuar ligjor.

Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e kuvendeve të komunave. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të komunave.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të kuvendeve të komunave, për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe organet e komunave të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Funksionimi i Kuvendeve të Komunave - Në Republikën e Kosovës në këtë periudhë kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave, të cilat kanë mbajtur mbledhje rregullisht. Sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun dhe transparente, me ç'rast janë transmetuar direkt përmes uebfaqes së Komunave dhe kanaleve të tyre në youtube, me përjashtim të Komunave veriore të cilat monitorohen fizikisht (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç, Zubin Potok dhe Novobërdë). Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 520 mbledhje. Prej tyre 399 kanë qenë të rregullta, 54 të jashtëzakonshme, 62 solemne dhe (5) urgjente.

Komitetet e Përhershme - Sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, në të gjitha komunat janë funksionale, marrë parasysh që themelimi i tyre është bërë në fillim të konstituimit të kuvendeve të komunave pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe ka vazhduar edhe në vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe Komitetet e përhershme kanë mbajtur 719 takime ku nga to, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 379 takime, kurse Komiteti për Komunitete 340 takime.

Komitetet tjera dhe komitetet konsultative

Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë themeluar komitetet tjera dhe komitetet konsultative. Sa i përket komiteteve tjera 17 komuna kanë ndërmarrë veprime në kuvend dhe kanë themeluar komitete tjera në 13 fusha si planifikim urban, arsim, kulturë, rini, sport, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, bujqësi, zhvillim ekonomik lokal, shërbime publike. Ndërsa komitete konsultative kanë themeluar 11 komuna për 8 fusha si: planifikim hapësinorë, arsim, kulturë, mbrojtje dhe ambient, zhvillim ekonomik lokal, shërbime emergjente, shëndetësi dhe mirëqenie sociale etj

Takimet Publike me Qytetarët - Gjatë kësaj periudhe në komunat e Republikës së Kosovës, gjithsej 26 Komuna kanë përmbushur obligimet ligjore për të mbajtur së paku 2 takime publike me qytetarët. 10 komuna kanë mbajtur vetëm nga 2 takim me qytetarët. Komuna e Fushë Kosovës Novobërdë nuk ka mbajtur asnjë takim publik me qytetarët brenda kësaj periudhe raportuese.

Raportimi i Kryetarit të Komunës - Lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të paraqitur raport para anëtarëve të Kuvendit të Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë kësaj periudhe kanë raportuar gjithsej 36 kryetarë të komunave, para Kuvendit Komunal, sa i përket situatës ekonomike-financiare të komunës. Ndërsa në komunën e Mamushës dhe Klllokotit, kryetarët nuk kanë raportuar asnjëherë për gjendjen ekonomike financiare.

Aktet e Kuvendeve të Komunave

Gjatë kësaj periudhe, janar-dhjetor, 2022, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 2300 akte, prej të cilave 109 rregullore dhe 2191 vendime, ku nga MAPL janë vlerësuar 1106 akte, ndërsa në Ministri të Linjës janë dërguar 1194 akte.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve në komuna, 1038 akte i ka vlerësuar të ligjshme, ndërsa në rishqyrtim komunave ju ka kthyer 68 akte, nga të cilat komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 61 akte, ashtu siç është kërkuar nga MAPL, ndërsa 7 akte mbesin të pa rishqyrtuara ku për 5 akte është dërguar shkresë në MD për tu kundërshtuar në gjykatë pas kalimit të afatit për rishqyrtim, ndërsa 2 akte

tjera janë brenda afatit ligjor për rishqyrtim.

Ndërsa sa i përket akteve të dërguara në Ministri të Linjës, MAPL në këto ministri ka përcjellë për vlerësim 1194 akte, prej të cilave nga Ministrinë e Linjës 1084 akte janë konfirmuar si të ligjshme, ndërsa 110 janë konstatuar të kundërligjshme prej të cilave komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 101 akte, ndërsa 9 tjera kanë mbetur kërkesa për rishqyrtim.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi - KKSB, është mekanizëm me rëndësi për ndërmarrjen e masave preventive lidhur me parandalimin e dukurive negative dhe rritjen e sigurisë publike. Në bazë të Ligjit për Policinë, dhe UA Nr.08/2009 MPB-02/2009 MAPL, numri i përgjithshëm i takimeve në komuna i KKSB-ve, është 159 e prej të cilave 19 komuna kanë përmbushur kriterin ligjor për të mbajtur 6 takime. Në 14 komuna KKSB-të edhe pse kanë mbajtur takime nuk kanë arritur të përmbushin kriterin ligjor për të mbajtur nga 6 takime ashtu siç përcaktohet me udhëzim. Ndërsa në 5 komuna nuk janë themeluar nga kuvendet e komunave KKSB-të.


1. FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Mbledhjet e kuvendeve të komunave

Kuvendi i Komunës sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është organi më i lartë i komunës. Kuvendi është organ vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës. Kuvendi duhet të mbajë së paku 10 mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve, varësisht nga nevojat.

Në Republikën e Kosovës në këtë periudhë kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave, të cilat kanë mbajtur mbledhje rregullisht. Vlen të theksohet që kuvendet e komunave Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan në muajin nëntor përkatësisht me datën 6 Nëntor 2022, kanë ofruar dorëheqjet së bashku me kryetarët e këtyre komunave dhe pas kësaj, anëtarët e kuvendeve Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok janë zëvendësuar nga KQZ, të cilët kanë dhënë betimin dhe kanë vazhduar me mbajtjen e mbledhjeve ku kanë zgjedhur Kryesuesit e rinj të Kuvendeve. Ndërsa sa i përket Kryetarëve të komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, Presidentja e Kosovës ka shpallur zgjedhjet të cilat janë caktuar të mbahen gjatë muajit Prill 2023, e në të njëjtën kohë zgjedhje do ketë edhe për kuvendet e komunave Zveçan dhe Leposaviq, marrë parasysh që në listat e pritjes nuk ka pasur kandidat në pritje për tu zëvendësuar.

Sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun, mbledhjet e kuvendeve kanë qenë transparente me ç'rast janë transmetuar direkt përmes uebfaqes së Komunave dhe kanaleve të tyre në youtube , me përjashtim të Komunave veriore të cilat monitorohen fizikisht (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Novobërdë). Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 520 mbledhje. Prej tyre 399 kanë qenë të rregullta, 54 të jashtëzakonshme, 62 solemne dhe (5) urgjente:



Grafikoni 1: Mbledhjet e kuvendeve të komunave.

Siç shihet, nga grafikoni komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e mbledhjeve, ashtu siç e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 43.2. Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe raportuese, në përgjithësi komunat kanë kryer obligimin ligjor në raport me MAPL-në, si dhe me publikun, duke informuar në vazhdimësi për mbajtjen e mbledhjeve, sipas afatit të përcaktuar ligjor, duke bërë përjashtim në disa raste komuna e Novobërdës dhe Malishevës. Në këto raste MAPL përmes shkresave ka njoftuar komunat që aktet e miratuara në mbledhjet që nuk janë përcjellë me kohë njoftimet për mbledhje si dhe materialet, nuk krijojnë efekt juridik.

Mbarëvajtja e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, gjatë kësaj periudhe në përgjithësi ka qenë konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, por janë evidentuar edhe raste të ndërprerjes së mbledhjeve apo bojkotim të kuvendeve nga anëtarët e subjekteve të ndryshme politike, të cilat do t'i paraqesim në vijim për secilën komunë veç e veç:

Deçan

Anëtarët e kuvendit nga subjektet politike nga LDK-dhe VV, kanë lëshuar mbledhjen e K.K, pasi që nga subjekti politik i AAK-së, janë propozuar për anëtarë të komisionit edhe përfaqësuesin nga sektori jo qeveritar, në shenjë mos pajtimi me faktin se propozimi nuk ka ardhë nga sektori jo qeveritar por nga subjekti politik i AAK-së këto subjekte politike kanë lëshuar mbledhjen. Pas shqyrtimit të kësaj pike LVV janë kthyer në sallë, ndërsa LDK nuk janë kthyer dhe nuk kanë marrë pjesë në shqyrtimin e pikave të mbetura të mbledhjes së Kuvendit të dt.30 Maj.

Klinë

Një rast ka ndodhur kur tri subjekte politike PDK dhe VV kanë lëshuar mbledhjen në seancën e III-të, me arsyetimin se ekzekutivi nuk po i plotëson kërkesat e tyre.

Istogu

Në mbledhjen e datës 03.02.2022 anëtarët e kuvendit të komunës nga subjektet politike LDK-së dhe PDK-së lëshojnë mbledhjen. Me datën 09.02.2022 (mbledhjen urgjente) anëtarët e KK nga radhët e AAK-së dhe LVV lëshojnë mbledhjen. Me datë 25.03.2022, bojkotojnë mbledhjen për shkak të shkarkimit të kryesueses së KK.

Podujevë

Lëshim të mbledhjeve ka pasur edhe në kuvendin e komunës së Podujevës në disa raste si në vijim;

- Në mbledhjen e datës 28.02.2022, në pikën 5 të rendit të ditës, Grupi i anëtarëve të kuvendit nga LDK-së ka deklaruar se tani e tutje në këtë mbledhje nuk do të marrim pjesë efektivisht në punime edhe pse do të qëndrojmë në sallë. Kjo me arsyetim të mos përfshirjes së përfaqësuesve të LDK-së në Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale.
- Po ashtu në mbledhjen e datës 20.05.2022, nga LVV, AAK dhe anëtari i subjektit OBKD lëshojnë mbledhjen si shkak i sjelljes së një anëtari të Kuvendit nga radhët e Grupit të LDK-së i cili gjatë kohës sa e kishte fjalën drejtori i Drejtorisë së Arsimit, hedh ujë në drejtim të tij.
- Në mbledhjen e datës 29.09.2022, nga Grupi i LDK-së dhe një anëtare e Grupit të AAK-së lëshohet mbledhja me arsyetimin se partia në pushtet vazhdimisht po përdorë arrogancën e numrave dhe po ka çasje refuzuese të bashkëpunimit.
- Në mbledhjen e datës 31.10.2022, përkatësisht në vazhdimin e mbledhjes më 07.11.2022, në pikën e 6-të të rendit të ditës nga LDK lëshohet mbledhja me arsyetimin se vazhdimi i mbledhjes duhet të fillojë nga pika e parë e rendit të ditës ngase pikat e shqyrtuara dhe miratuara më 31.10.2022 dhe në vazhdimin e parë më 03.11.2022, janë kaluar pa debat dhe pa shqyrtim të tyre për shkak të veprimeve demonstrative të Grupit të LDK-së tek foltorja e Kuvendit për mos procedimin e kompensimeve për seancën e datës 29.09.2022 për anëtarët e LDK-së dhe 1 të AAK-së të cilët qysh në fillim të mbledhjes ende pa u miratuar rendi i ditës lëshuan mbledhjen duke u deklaruar se nuk do të marrim pjesë në këtë seancë.
- Gjithashtu më 07.11.2022, pas një pauze dhe caktimit të kohës për vazhdimin e mbledhjes, Grupi i LDK-së dhe 1 anëtare e Grupit të AAK-së nuk marrin pjesë fare në vazhdimin e punimeve të kësaj seance, e që në fakt i bie "bojkotim" i vazhdimit të mbledhjes, dhe atë me arsyetimin e njëjtë se mbledhja duhet të vazhdojë nga pika e parë e rendit të ditës, konkretisht nga fillimi ngase sipas tyre pikat e shqyrtuara janë kaluar pa diskutim dhe në kohës sa Grupi i LDK-së ishte tek foltorja duke u munduar pamundësimin e zhvillimit të seancës.

Gjilan

Anëtarët e kuvendit të komunës së Gjilanit nga subjektet politike LDK, AAK dhe VATRA e kanë lëshuar mbledhjen e kuvendit të datës 29.06.2022. Kjo ka ndodhur gjatë diskutimit rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023/2025, duke shprehur mospajtime rreth Kornizës si dhe mospajtime me

Drejtorin e Buxhetit dhe Financave rreth borxheve të trashëguara nga qeverisja e mëhershme në komunë. Po ashtu lëshime të mbledhjes ka pasur edhe në mbledhjen e VIII të mbajtur më 28.07.2022 e ka lëshuar opozita për arsye të debatit rreth raportimit të Kryetarit të Komunës për Raportin 6 mujor, dhe ne mungesë të kuorumit mbledhja është ndërprerë për të vazhduar më datë 01.08.2022 (mungesës së kuorumit nga që opozita nuk ju ka përgjigjur ftesës) dhe më 05.09.2022 ku opozita e ka lëshuar mbledhjen për arsye të mos pajtimeve rreth kërkim faljes nga ana e Kryetarit të Komunës, dhe me këtë rast Kryesuesi e ka mbyllur mbledhjen dhe pikat e pashqyrtuara janë bartur në mbledhjen e radhës e cila është mbajtur më 29.09.2022 ku prapë opozita e ka lëshuar mbledhjen për arsye të njëjta dhe mbledhja ka vazhduar më 30.09.2022 (opozita nuk ju ka përgjigjur ftesës) dhe ka përfunduar me miratimin e Buxhetit për vitin 2023 nga që kishte kuorumin e mjaftueshëm për të marr vendime.

Malishevë

- Sa i përket lëshimit të mbledhjeve ka pasur në KK të Malishevës, me dt.30.06.2022 ku dy anëtar të VV, tre nga LDK dhe PDK kanë lëshuar mbledhjen gjatë debatit në pikën e dytë.

Vushtrri

24 nëntor 2022 - Arsyeja e lëshimit të mbledhjes është bërë për shkak të mos pajtimit lidhur me votimin e një pikë të rendit të ditës nga mbledhja e kaluar, lidhur me ndërtimin e lapidarit në Pasomë.

- 29 dhjetor 2022 - Arsyeja e lëshimit të mbledhjes nga disa deputetë është bërë për shkak të mos hedhjes në votim, propozimi i një anëtarit për mocionin e shkarkimit të kryesueses (propozim, ky i cili ishte në kundërshtim me statutin).

Dragash

- Po ka pasur një rast, arsyeja e lëshimit të mbledhjes ka qenë sepse në atë seancë nuk ka pasur në rend dite pikë eventuale, mbledhjen e ka lëshuar një subjekt politik, dhe mbledhja ka vazhduar me pjesën e tjetër të delegatëve. (kjo ka ndodhur në mbledhjen e XI të datës 15.11.2022).

Shtime

- Edhe në kuvendin e komunës së Shtimes ka pasur rast të lëshimit të mbledhjes ku anëtarët e kuvendit nga PDK kanë lëshuar mbledhjen e mbajtur më 28.02.2022, dhe si pasojë e kësaj nuk ka pasur kuorum për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit.


Kamenicë

- Në Kuvendin e komunës së Kamenicës në mbledhjen e datës 28.04.2022, është ndërprerë në mungesë të kuorumit. Arsyeja ka qenë gjendja shëndetësore e 2-3 anëtarëve të kuvendit, por e njëjta mbledhje ka vazhduar me datën 29.04.2022.

2. KOMITETET E PËRHERSHME TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kuvendi i Komunës themelon trupat ndihmëse me qëllim të shqyrtimit të hollësishëm të politikave strategjike komunale, akteve të tjera si rregullore, vendime dhe plane, nga njëra anë, si dhe me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarisë organit ekzekutiv, në anën tjetër. Prandaj Kuvendi i Komunës themelon komitete të përhershme të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre

kompetencave. Gjatë kësaj periudhe Komitetet e përhershme kanë mbajtur 719 takime ku nga to, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 379 takime, kurse Komiteti për Komunitete 340 takime. Numri i takimeve të komiteteve të obligueshme është paraqitur si në vijim:



Grafikoni 2: Takimet e komiteteve të përhershme.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si trup kryesor këshillëdhënës i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizës vjetore buxhetore afatmesme, planit vjetor të prokurimit, rregullores vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm, planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin komunal. Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 379 takime.

Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete, përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në Komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Komiteti për Komunitete i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës. Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 340 takime.

3. KOMITETET E TJERA

Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në një fushë të caktuar, Kuvendi i Komunës në pajtim me nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale themelon komitete të tjera të cilat do të ndihmojnë atë dhe ekzekutivin në punën e tyre. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Gjatë vitit 2022, vetëm (17) komuna kanë ndërmarrë veprime në kuvend dhe kanë themeluar komitete tjera në (13) fusha, si planifikim urban, arsim, kulturë, rini, sport, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, bujqësi, zhvillim ekonomik lokal dhe shërbime publike.

Në vijim përmes tabelës kemi paraqitur komunat te cilat i kanë themeluar komitetet e tjera:

Komunat	Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	Arsim Kulturë rini dhe Sport	Planifikim Hapësiror mbrojtje të	Pronë Kadaster	Zhvillim Ekonomik	Nevoja të veçanta	Shërbime Publike	Bujqësi	Dinopor	Bashkëpunim bashkëqytetar	Kategoritë e Dala nga Lufta	Zhvillim Ekonomik	Barazi Gjimore
Istog													1
Peja	1	1	1										
Klina	1	1	1	1			1						
Podujeva	1				1								1
Lipjani	1	1											
Shtime	1	1					1						
Mitrovica Jugore	1	1	1				1					1	1
Vitia	1	1	1				1						1
Fushë-Kosova	1	1				1	1	1					
Prizreni	1	1					1	1					1
Gjakova							1						1
Prishtina	1	1	1	1			1	1					1
Gjilani	1	1	1	1			1			1		1	1
Kamenica	1	1	1				1						1
Malishevë	1	1						1	1		1		1
Rahovec	1	1											
Gracanica		1				1	1						

Tabela 1: Numri i komiteteve të tjera.

4. Komitetet Konsultative

Kuvendi i Komunës, bazuar në nenin 73, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe UA (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, është i obliguar të themelojë

edhe komitetet konsultative, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Gjatë vitit 2022, 11 komuna kanë ndërmarrë veprime në kuvend dhe kanë themeluar komitete Konsultative në 8 fusha, si planifikim hapësinor, arsim, kulturë, mbrojtje dhe ambient, zhvillim ekonomik lokal, shërbime emergjente, shëndetësi dhe mirëqenie sociale etj.

Në vijim përmes tabelës do të paraqesim komunat të cilat i kanë themeluar Komitetet konsultative :

Komunat	Planifikim hapësinor	Arsim kulturë rini sport	Komiteti për bujqësi dhe zhvillim rural	Mbrojtje dhe Ambient	Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale	Zhvillim Ekonomik, planifikim mb.mjedisit	Persona me aftësi të Kufizuara	Komiteti për shërbime publike emergjente	
Istog							1		
Peja				1		1	1		
Klina			1					1	
Podujeva									
Gjilani	1						1		
Hani i Elezit					1	1		1	
Mitrovicë e Jugut		1			1	1			
Kamenicë					1		1	1	
Gjakovë		1			1				
Prishtinë							1		
Kaçanik							1		


Tabela 2: Numri i komiteteve konsultative .

5. TAKIMET PUBLIKE ME QYTETARËT

Komunat si njësi vetëqeverisëse lokale duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 68.1, janë të obliguara të vënë në funksion takimet publike, si parime bazë të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarë, ku secili person apo organizatë me interes ka të drejtë të marr pjesë. Kuvendi i Komunës përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë njofton qytetarët e komunës së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit ku njoftimi përmban datën, kohën, vendin e mbajtjes së takimit dhe rendin e ditës.

Komunat gjatë kësaj periudhe janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetarëve me rastin e diskutimeve publike.

Të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2022



Grafikoni 3: Numri i takimeve publike me qytetarët


Gjatë kësaj periudhe në komunat e Republikës së Kosovës, gjithsej 26 Komuna kanë përmbushur obligimet ligjore për të mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë, ndërsa 10 komuna kanë mbajtur vetëm nga 1 takim me qytetarët. Komunitat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarët brenda kësaj periudhe raportuese, janë komunat: **Novobërdë dhe Fushë Kosovë**.

Komunitat pos takimeve publike me qytetar, ashtu siç përcaktohet më nenin 68.1 kanë mbajtur edhe konsultime publike me qytetarë për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me miratimin e rregulloreve komunale, planet zhvillimore, hartat zonale, kornizën afatmesme buxhetore.

Komunitat, pos takimeve publike me qytetarë, ashtu siç përcaktohet më nenin 68.1 kanë mbajtur edhe konsultime publike me qytetarë për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me miratimin e rregulloreve komunale, planet zhvillimore, hartat zonale kornizën afatmesme buxhetore. Edhe pse komunitat kanë organizuar konsultime publike me qytetarët, pjesëmarrja e tyre në këto takime ka qenë e vogël.

6. RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS PËR SITUATËN EKONOMIKO-FINANCIARE TË KOMUNËS

Ligji Nr.03/L-040 për vetëqeverisje Lokale, nenit 58, paragrafi j, ka paraparë që kryetari i komunës është i obliguar të raportojë para kuvendit të komunës së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës. Në vijim në formë tabelore po i paraqesim numrin e raportimeve të Kryetarit gjatë kësaj periudhe:



Grafikoni 4: Raportimi i kryetarëve të komunave.


Gjatë kësaj periudhe Janar- Dhjetor, 2022, kanë raportuar gjithsej 36 kryetarë të komunave, para Kuvendit Komunal, sa i përket situatës ekonomike-financiare të komunës. Ndërsa në komunën e **Mamushës dhe Klllokotit**, kryetarët nuk kanë raportuar asnjëherë për gjendjen ekonomike financiare.

7. AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës, ndër të tjera është miratimi i rregulloreve, vendimeve, planeve dhe akteve të tjera të nevojshme për zbatimin e legjislacionit sektorial që prek kompetencat e komunave.

Komunat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore, që rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret që janë miratuar gjatë kësaj periudhe kohore janë: miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike, rregullore për tatimin në pronë, rregullore për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale etj.

Në vijim, përmes grafikunit kemi paraqitur numrin e akteve të miratuara nga kuvendet e komunave.



Grafikoni 5: Numri i akteve të miratuara nga kuvendet e komunave.

Nga grafikoni 5, vërejmë se në përgjithësi kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsejtë 2300 akte, prej të cilave 2191 vendime dhe 109 rregullore. Kuvendi i Komunës që ka miratuar më së shumti akte është Kuvendi i Komunës së Rahovecit (112 akte nga të 110 vendime dhe 2 rregullore), e pasuar nga Kuvendi i komunës së Mitrovicës së Jugut me 99 vendime dhe 4 rregullore si dhe K.K. Malishevë 99 vendime dhe 5 rregullore, ndërsa me numrin më të vogël të akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe të raportimit ka qenë Kuvendi i komunës së Zveçanit dhe Leposaviçit me nga (9 akte).

7.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

MAPL është autoriteti mbikëqyrës i ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar kompetencat. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QRK) NR-10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrisë së Pushtetit Lokal në përgjithësi ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendeve të komunave është bërë në afatin e përcaktuar ligjor brenda 7 ditë nga miratimi i akteve në kuvendin e komunës.

Në periudhën Janar- Dhjetor 2022, Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë miratuar gjithsejtë 2300 akte, prej të cilave 109 rregullore dhe 2191 vendime, ku nga MAPL janë vlerësuar 1106 akte, ndërsa në Ministri të Linjës janë dërguar 1194 akte. Këto akte janë pjesë e obligimeve ligjore të komunave dhe kërkohet të jenë në harmoni


të plotë me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve në komuna, 1038 akte i ka vlerësuar të ligjshme ndërsa në rishqyrtim komunave ju ka kthyer 68 akte, nga të cilat komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 61 akte, ashtu siç është kërkuar nga MAPL, ndërsa 7 akte mbesin të pa rishqyrtuara ku për 5 akte është dërguar shkresë në MD për tu kundërshtuar në gjykatë pas kalimit të afatit për rishqyrtim, ndërsa 2 akte tjera mbesin kërkesa për rishqyrtim.

Natyra e shkeljeve të evidentuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Aktet e komunave që janë kthyer në rishqyrtim kryesisht dominojnë ato të cilat kanë të bëjnë më formimin e komiteteve të përhershme të kuvendit të komunës të cilat nuk janë në harmoni me ligjin për barazi gjinore, emërimin e nënkryetarëve për komunitete, zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete, rregulloreve të punës së kuvendit, vendimet për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave si dhe ankesave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim si dhe formimin e KKSBB-ve, vendimet për themelimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, vendimeve për themelimin e drejtorive komunale që nuk janë paraparë në statutet e komunave etj.

7.1.1 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal




Grafikoni 6: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga MAPL

Siç shihet edhe nga grafikoni i mësipërm, nga gjithsej 1106 akte të shqyrtuara nga MAPL, 1038 janë konfirmuar si të ligjshme, ndërsa në rishqyrtim komunave ju kanë kthyer 68 akte, nga të cilat komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 61 akte, ashtu siç është kërkuar nga MAPL, ndërsa 7 akte mbesin të pa harmonizuara ku 2 edhe pse janë rishqyrtuar nuk janë harmonizuar, ndërsa 5 akte tjera të cilat nuk janë rishqyrtuar fare nga komunat, 5 nga to MAPL bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, për aktet të cilat nuk janë rishqyrtuar dhe harmonizuar konform kërkesës se bazuar në legjislacionin në fuqi, i ka dërguar në Ministri të Drejtësisë, që përmes Avokaturës Shtetërore të kundërshtohen në Gjykatë.

7.1.2 Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministritë e linjës

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga Ministritë e linjës



Grafikoni 7: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nga ministritë e linjës.

Sa i përket akteve të dërguara në Ministritë e Linjës, MAPL në këto ministri ka përcjellë për vlerësim 1194 akte, e prej të cilave nga Ministritë e Linjës 1084 akte janë konfirmuar si të ligjshme, ndërsa 110 janë konstatuar të kundërligjshme.

Për të gjitha shkeljet e konstatuara, nga Ministritë e linjës, komunave i'u është dërguar nga to kërkesa për rishqyrtim dhe MAPL ka monitoruar procesin e rishqyrtimit të tyre në kuvendet e komunave ku është konstatuar se komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 101 akte, ndërsa 9 akte tjera që mbesin të pa harmonizuara 5 nga to MAPL i ka dërguar në Ministri Drejtësisë që përmes Avokaturës Shtetërore të kundërshtohen në Gjykatë, ndërsa 4 tjera mbesin të pa rishqyrtuara dhe harmonizuara.

Natyra e shkeljeve të evidentuara nga Ministritë e linjës

Aktet e kthyer nga Ministritë e linjës kanë të bëjnë me caktimin e normave tatimore, komisionet për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës së banimit për familjet me raste sociale, caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevoja të komunitetit, hartimin e planeve zhvillimore komunale, miratimin e rregulloreve për tarifa dhe gjoha komunale, planeve për menaxhimin e mbeturinave, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, vendimet për aprovimin e bonuseve të zoonimit sipas hartave zonale, vendime që kanë të bëjnë me mbrojtjen e vlerave të natyrës etj. Akte, që kanë të bëjnë me trajtimin e mënyrës së shfrytëzimit të hapësirës publike, rregulloreve për subvencione, lirimin e pagesave të fëmijëve në çerdhe, bartjen e mjeteve financiar, krijimin e kodeve për participim të qytetarëve në projekte të ndryshme etj.


8. KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Në nivelin lokal, trupa me rëndësi për sigurinë publike të qytetarëve por edhe më gjerë janë Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Themelimi i KKSB-së bazën ligjore e ka me Ligjin për Policinë, ndërsa përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligimet tjera fillimisht janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL.

Me ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, është definuar edhe më qartë pozicioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në raport me komunën. Edhe me këto ndryshime normative është përcaktuar roli preventiv i këtij Këshilli ndaj dukurive negative në shoqëri dhe janë përcaktuar një numër i objektivave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit.

Me udhëzimin administrativ për KKSB, ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve në vit, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë. Për numrin e takimeve, është paraqitur grafikoni në vijim:

Takimet e KKSBS-së



Grafikoni Nr.1. Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Numri i përgjithshëm i takimeve në komuna të KKSBS-ve, është 159 takime, ku nga to 19 komuna kanë përmbushur kuotën ligjore për të mbajtur 6 takime e prej të cilave Komuna e Rahovecit dhe Kamenicës kanë mbajtur nga 7 takime, pastaj me 6 takime të mbajtura janë: Prizren, Junik, Prishtinë, Pejë, Lipjan, Hani i Elezit, Suharekë, Glllogoc, Vushtrri, Klinë, Skenderaj, Obiliq, Viti, Dragash, Malishevë, Rahovec, Kaçanik, ndërsa komunat që nuk e kanë përmbushur kuotën ligjore por kanë mbajtur takime si vijon: 5 takime të KKSBS-së kanë mbajtur komunat: Mitrovicë e Jugut, Istog, Shtërpcë, me nga 4 takime komunat: Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Podujevë me nga 3 takime komunat: Deçan, Graçanicë, me nga 2 takime komunat: Mamushë, Kllokot, Ranillugë dhe me nga 1 takim komunat: Fushë Kosovë dhe Partesh. Ndërsa në 5 komuna (Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok) nuk janë themeluar nga kuvendet e komunave KKSBS-të.

8.1. Temat e trajtuara lidhur me sigurinë në bashkësi;

Temat e diskutuara sipas komunave:

- Planet operative të ndërmarra nga Policia e Kosovës për ushtrimin e kontrollit me te rreptë të trafikut rrugor, për te zvogëluar aksidentet me fatalitet dhe sfidat
- Siguria e përgjithshme
- Aksidentet në trafik, qentë endacak, infrastruktura
- Mbrojtja e lumenjve
- Deponitë ilegale, menaxhimi i mbeturinave
- Raporti mbi gjendjen e kamerave të sigurisë Komuna,
- Shqyrtimi i dukurive negative që e preokupojnë shoqërinë në përgjithësi
- Dhuna në familje
- Vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin e zjarreve në sezonin verorë
- Monitorimi dhe raportimi i gjendjes së sigurisë dhe zbatimi i planit për siguri nëpër shkolla
- Masat e parandalimit të lëmshë-kërkuesve
- Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit

multikulturorë dhe ndër fetarë

- Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta
- Masat paraprake për sezonin dimërorë
- Masat paraprake në ruajtjen e ambientit dhe pyjeve
- Identifikimin e brengave të qytetarëve lidhur me sigurinë publike
- Vetëdijesimi i nxënëseve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta
- Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve
- Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm
- Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror

Komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët nga ana e policisë në komunitet

8.2. Sfidat

Sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohet Këshilli Komunal në Siguri në Bashkësi janë:

- Gjetja e fondeve për realizimin e projekteve të propozuara nga KKSB-të
- Pagesa e anëtarëve të KKSB-së
- Ndotja e Ambientit
- Vendosja e nënkalimeve në rrugët kryesore sidomos afër shkollave;
- Siguria në trafik
- Lirimi i hapësirave publike
- Qentë endacak etj.

Rekomandime të Përgjithshme

- Dërgimi i listës së akteve të miratuara nga kryetarët e komunave, ashtu si është e përcaktuar në nenin 80.1 të LVL-së;
- Komunat (Malishevë dhe Novobërdë) të dërgojnë me kohë ftesat dhe materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendeve të komunave ashtu siç përcaktohet me nenin 43 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale.
- Komunat: Fushë Kosovë, dhe Novobërdë, të mbajnë takime publike me qytetarët ashtu siç përcaktohet me nenin 68.1 të LVL-së;
- Kryetarët e komunave (Kllokot dhe Mamushë), të raportojnë për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës;
- Kuvendet e komunave të bëjnë rishqyrtimin e akteve, ashtu siç përcaktohet në nenin 80.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të bëjnë rishqyrtimin e akteve të Komunave;
- Kuvendet e komunave Novobërdë, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok të bëjnë themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi sipas Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë dhe Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL;U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKS;B;
- Në komunat ku KKS;B-të, nuk kanë arritur të mbajnë 6 takime ashtu siç përcaktohet sipas Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë dhe Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL;U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKS;B, të ndërmarrin veprime konform udhëzimit administrativ të mbajnë takimet ashtu siç përcaktohen me udhëzim.
- Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e hartimit dhe miratimit të akteve juridike nënligjore;
- Komunat të dërgojnë për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL, aktet e miratuara nga kuvendet e komunave ashtu siç përcaktohet me nenin 43.5, të LVL.
- Kuvendet e komunave të cilat nuk kanë funksionale teleprezencën të ndërmarrin veprime që të funksionalizojnë teleprezencën apo mbledhjet e KK të transmetojnë përmes platformave si youtube, fb apo ueb faqeve të komunave, që t'i bëhet e mundur zyrtarit për monitorim përcjellja e drejtpërdrejtë e mbledhjeve të kuvendit, sipas Udhëzimit administrativ Nr. 2012/01 për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendeve komunale përmes teknologjisë informativë me pajisjet e "Teleprezencës".